

Pyetje dhe Përgjigje

Thirrja për Grantet Rajonale dhe të Iniciativës (16510-G03)

1. OSHC-të që kanë aplikuar tek thirrjet për grante Rajonale të kaluara (16510-G02) dhe NUK janë shpallur fitues a mund të riaplikojnë tek thirrjet e tanishme me të njëjtin projekt propozim? Nëse po, çfarë duhet të përmirësojnë tek propozimi i mëparshëm për të realizuar një propozim projekti që është në përputhje me objektivat e GreenAL?

OSHC-të që kanë aplikuar tek thirrja e mëparshme për Grantet Tematike dhe Rajonale (16510-G02) dhe që NUK janë shpallur fitues, mund të riaplikojnë në këtë thirrje me të njëjtin projekt propozim. Por sygjerojmë që të përmirësojnë aplikimin e tyre në varësi të rekomandimeve dhe komenteve që iu përcollën për aplikimin e mëparshëm të kryer si dhe t'i referohen objektiva/pikave të thirrjes aktuale, për ta sjellë propozimin në përputhje me të.

2. Organizatat që aplikojnë si aplikant kryesor (për Grantet Rajonale dhe të Iniciativës) duhet të kenë 5 vite të plotë eksperience nga regjistrimi në Gjykatë në momentin që aplikojnë?

Po, organizatat që aplikojnë në këtë thirrje si aplikant kryesor duhet të kenë përmbushur 5 vite nga regjistrimi i tyre në Gjykatë në momentin që aplikojnë për Grantet Rajonale ose të Iniciativës.

3. Sa vite eksperiencë duhet të kenë bashkëaplikantët që aplikojnë në këtë thirrje?

Bashkëaplikantët duhen të kenë minimalist një (1) vit eksperiencë nga regjistrimi në Gjykatë për të aplikuar për këtë thirrje. Referohuni pikës 2.2.2 të Udhëzuesit të thirrjes për më tepër informacion mbi bashkëaplikantët.

4. A është e nevojshme që bashkëaplikantët të kenë të përcaktuar në fokusin e tyre mjedisin?

Jo, nuk është e nevojshme që bashkëaplikantët të kenë mjedisin të përcaktuar si fokus të drejtpërdrejtë në misionin ose statutin e tyre. Megjithatë, është e domosdoshme që në CV-në apo historikun e tyre të kenë eksperiencë të mëparshme, projekte ose aktivitete që lidhen me mjedisin.

5. Jam i/e regjistruar si një person fizik, a mund të aplikoj në këtë thirrje si i/e tillë së bashku me një organizatë?

Personat fizik NUK mund të vijnë si aplikant kryesor dhe/ose si bashkëaplikant në këtë thirrje por, nëse kanë një ide për një iniciativë, ata mund të bashkëpunojnë me një organizatë me fokus mjedisin për ta adresuar çështjen e ngritur nëpërmjet kësaj thirrje. Personi fizik në këtë rast mund të bëhet pjesë e projektit si ekspert i jashtëm, ose të bëhet punojnës i organizatës në fjalë.

6. Si mund të përfshihet një operator ekonomik si partner në këtë projekt?

Një operator ekonomik/biznes/kompani mund të përfshihet si "aplikantit pa buxhet" në një aplikim të kësaj thirrje, siç përcaktohet në udhëzues. Vendimi për të bashkëpunuar me një aplikant të tillë mbetet në gjykimin e aplikantit kryesor. Bashkëpunimi mund të ndodhi nëse operatori ekonomik ka një mision ose veprimtari që përputhet me objektivat e projektit dhe angazhohet të ofrojë kontributin e tij (ekspertizë specifike, burime të caktuara, infrastrukturë, etj.) pa synim përfitimin financiar të drejtpërdrejtë nga ky bashkëpunim specifik.

Në këtë rast:

- Operatori ekonomik nuk do të ketë buxhet nga granti brenda propozimit kryesor.

- Aplikanti kryesor (organizata që merr përsipër grantin) duhet të vlerësojë dhe të argumentojë qartë në propozimin e projektit vlerën e shtuar që operatori ekonomik sjell në arritjen e objektivave të projektit.
- Roli dhe detyrat specifike të operatorit ekonomik si partner "pa buxhet" duhet të detajohen qartë në propozimin e projektit dhe në marrëveshjen e partneritetit të firmosur midis aplikantëve të propozimit.

7. A lejohet të angazhohet si ekspert në projekt një person i cili është i punësuar në një institucion publik ose universitet publik? Nëse po, cilat janë kushtet dhe kufizimet e zbatueshme për pagesën e tij?

Po, thirrja lejon angazhimin e një eksperti që punon në një institucion publik ose universitet publik. Megjithatë, eksperti i punësuar në sektorin publik NUK duhet të marrë shpërblim financiar ose pagesë shërbimi për kontributin e tij në projekt, nëse ekspertiza e ofruar është pjesë e detyrave që ai duhet të bëjë si pjesë e punës së tij të rregullt ose shërbimeve të institucionit, atëherë as ai vetë, as institucioni, nuk mund të paguhet shtesë nga projekti.

8. A ka një kufizim deri në sa përqindje të buxhetit mund të përdoret për pagat?

Jo, nuk ka një kufizim të përcaktuar. Megjithatë, çdo projekt propozim duhet të ketë justifikime të arsyeshme për shpenzimet e pagave. Përqindja e buxhetit të alokuar për paga mund të variojë në varësi të objektivave të projektit. Për shembull, një projekt studimor mund të ketë nevojë për një përqindje më të lartë të kostove të pagave, ndërsa një projekt me më tepër lëvizje në terren mund të ketë nevojë më të lartë për kompensime udhëtimi.

9. A është aspekt skualifikues ndarja në përqindje e zërave të buxhetit?

Jo, ndarja në përqindje e zërave të buxhetit nuk është aspekt skualifikues, por është shumë e rëndësishme që kjo ndarje të jetë e justifikuar mirë dhe e qartë. Çdo zë buxheti duhet të përputhet me aktivitetet e planifikuara dhe qëllimet e projektit, duke treguar qartë se si përqindjet e ndara ndihmojnë në zbatimin efektiv të projektit. Transparenca dhe logjika pas shpërndarjes së fondeve janë thelbësore për një vlerësim pozitiv.

10. Si duhet të strukturohet buxheti i projektit, si duhet të shpërndahen zërat dhe kostot?

Buxheti i projektit duhet të strukturohet në zëra që lidhen me aktivitetet e planifikuara dhe objektivat e projektit, si kostoja e personelit, udhëtimet, pajisjet, shërbimet, publikimet, aktivitetet dhe kosto të tjera. Shpërndarja e kostove në këto zëra duhet të jetë e justifikuar dhe e detajuar, duke treguar nevojën e çdo shpenzimi për zbatimin e suksesshëm të projektit. Është thelbësore që buxheti të jetë i detajuar, i justifikuar, me llogaritje realiste dhe në përputhje me formatin dhe udhëzimet specifike të përcaktuara në Udhëzuesin e Grantit.

11. Si përllogaritet paga e personave që do angazhohen në projekt, nëse personat rezultojnë të punësuar në OSHC-të aplikuese?

Për llogaritjen e pagave të stafit, duhet të përcaktohen rolet, koha e angazhimit në projekt dhe kosot mujore e pagës për çdo rol. Në llogaritjen e kosos së pagës duhet të përfshihen kontributet sociale dhe shëndetësore të punëdhënësit sipas legjislacionit në fuqi.

12. Tek Shtojca dy (2) e aplikimit, Buxheti, ku duhen detajuar shpenzimet për aktivitetet që parashikohen në projekt propozim?

Këto shpenzime të vendosen nën zërin nr. 5 (*Kosto të tjera specifike*) të Shtojcës 2 (Buxhetit).

13. Për LOT 1 (Grantet Rajonale) a është e lejueshme që të blihen pajisje monitorimi nga fondet e grantit nëse është brenda vlerës së investimit që lejohet (25%)?

Po, por duhet të specifikohen pajisjet e monitorimit që do merren si dhe të justifikohet se përse do behet ky investim dhe si do sigurohet vijimësia e investimit. Gjithashtu, nëse parashikohet blerja e pajisjeve të monitorimit të ngjashme me ato që ofron GreenAL (të detajuar tek [Metodologjia E Monitorimit](#)), duhet specifikuar perse nuk mund të përdoren pajisjet e monitorimit të ofruar nga GreenAL.

14. Tek Grantet Rajonale, ku nevojitet partneriteti i detyrueshëm me dy bashkëaplikant, a duhet përfshirë buxheti?

Po, buxheti i projekt propozimit duhet të përfshihet si shtojcë për çdo aplikim, edhe në rastet kur ka partneritet me dy bashkëaplikantë të tjerë. Duhet të dorëzohet një buxhet i vetëm i cili përmbledh të gjitha kostot e projektit, pavarësisht nga numri i partnerëve të përfshirë.

15. A mund të kryhet auditimi përmbyllës i projektit nga financieri i vetë OSHC-së (nëse është i licencuar) ose nga një ekspert i jashtëm kontabël që ka një kontratë shërbimi me OSHC-në, por nuk është punonjës i saj?

Jo, auditimi përmbyllës i projektit NUK mund të kryhet as nga financieri i OSHC-së (edhe nëse është i licencuar) dhe as nga eksperti i jashtëm kontabël që ka një kontratë shërbimi me OSHC-në.

Auditi duhet të realizohet nga një auditues i licencuar dhe i pavarur, i cili nuk ka lidhje të drejtpërdrejte me projektin apo me strukturat zbatuese të tij.

16. Si trajtohet TVSH-ja në kuadër të projektit? A është ajo një kosto e pranueshme?

TVSH-ja konsiderohet si një kosto e pranueshme nga projekti. Shpresohet që gjatë kohëzgjatjes së projektit, kjo të mos ndryshojë. Megjithatë, për të përfituar rimbursimin e TVSH-së, përfituesi i grantit duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të kërkuar rimbursimin nga autoritetet tatimore shqiptare. Vetëm nëse përfituesi merr një përgjigje negative zyrtare nga autoritetet shqiptare për rimbursimin e TVSH-së, atëherë kjo kosto mund të njihet si e pranueshme nga projekti.

Sipas pikës 2.4.2 të Udhëzuesit, taksat, përfshirë TVSH-në do të aprovohen si kosto të pranueshme vetëm kur të plotësohen kushtet e mëposhtme dhe konfirmohen nga dokumentet mbështetëse:

- taksat e vlerës së shtuar nuk janë të rimbursueshme në asnjë mënyrë;
- sipas praktikës, ato do të përballohen nga përfituesi; dhe
- ato pasqyrohen qartë në projekt propozim.

17. A mund të përfshijmë TVSH-në si pjesë të bashkëfinancimit të projektit?

Jo, TVSH-ja nuk mund të përfshihet si pjesë e bashkëfinancimit të projektit. Kjo sepse, sipas ligjit, TVSH-ja konsiderohet si një kosto e rimbursueshme dhe kjo natyrë e TVSH-së e përjashton atë si shpenzim për bashkëfinancim.

18. A është kufiri i shpenzimeve të investimit 25% e vlerës totale të Grantit Rajonal, apo 25% e vlerës së Grantit pas zbritjes së shpenzimeve të pagave?

Kufiri i shpenzimeve të investimit është 25% e vlerës totale të Grantit Rajonal.

19. A lejohet të vendosen kosto të paparashikuara në buxhetin e projektit?

Jo, nuk lejohet.

20. Nëse një financieri i kërkohet të punojë vetëm 5 ditë në muaj në kuadër të projektit, si duhet të pasqyrohet kjo në buxhet dhe si duhet të përcaktohet lloji i angazhimit të tij?

Mënyra e pasqyrimin në buxhet dhe përcaktimi i llojit të angazhimit varet nga kontrata që e përcakton marrëdhënien e punës së organizatës me financierin.

Nëse financieri ofron shërbime të specializuara për projektin, angazhimi i tij dokumentohet me kontratë shërbimi. Numri i ditëve (5 në muaj) dhe tarifa për ditë përcaktohen në kontratë. Shpenzimi pasqyrohet në Seksionin 4 të buxhetit, në kategorinë e "*Lista e Shërbimeve që do të Blihen*". Vlera totale e kontratës do të jetë kosto e shpenzuar për këtë shërbim.

Nëse financieri konsiderohet është staf i OSHC-së, angazhimi dokumentohet me kontratë pune sipas Kodit të Punës and përfshirja e tij në projekt varion sipas nevojës. Ditët e punës për të cilat, financieri do të punojë për projektin do të shënohen në kolonën e "*# i njëjësive*" në Seksionin e Parë të buxhetit, në kategorinë e "*Kostove të pagave të personelit të përfshirë në projekt*".

21. A ka ndonjë referencë për dietat (shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit)?

Jo, nuk ka.

22. A ka penalizime ose kushte të përcaktuara për ndarjen në përqindje të kostove midis zërave të buxhetit?

Jo, nuk ka kushte apo kufizime të përcaktuara në lidhje me ndarjen në përqindje të kostove midis zërave të buxhetit.

23. Për Grantet Rajonale, duke qenë se kërkohet shtrirje në më shumë se një bashki për projektin, cili është numri minimal i bashkive në të cilën mund të shrihet një projekt potencial Rajonal, dhe a mjafton që këto bashki të jenë brenda të njëjtit qark, apo kërkohet një shtrirje ndër-qark? Për Grantet Rajonale numri i bashkive në projekt duhet të jetë më tepër se një dhe një projekt Rajonale mund të jetë e shtrirë në një ose disa qark. Nuk ka një numër maksimal për shtrirjen, pasi kjo varet nga lloji i iniciativës që propozohet.

24. Nëse projekti fokusohet vetëm në veprime konkrete/aksione, pa përfshirë trajnime dhe studime, a ka ndonjë kufizim?

Nuk ka domosdoshmërisht një kufizim nëse projekti fokusohet vetëm në aksion, për sa kohë që kjo përputhet me objektivat dhe prioritetet e Grantit, dhe ndikimi i projektit është i qartë dhe i argumentuar mirë në propozim. Ju lutem referojuni seksionit të "*Llojeve të aktiviteteve të pranueshme*" dhe "*Kriteret të Vlerësimit*" në Udhëzues për më tepër.

25. A mundet që e nejtja organizatë të jetë dy (2) herë bashkëaplikant në LOT 1 dhe një (1) herë si aplikant kryesor në LOT 2?

Organizatat mund të aplikojnë deri në dy (2) herë në këtë thirrje. Pra mund të aplikojnë si Aplikant kryesor në LOT 2 dhe si bashkëaplikant në LOT 1. Por nëse vijnë si aplikant kryesor në LOT 1 nuk aplikojnë dot sërish.

Nëse organizata do të vij vetëm si bashkëaplikant në këtë thirrje, mund të jetë bashkëaplikant në LOT 1 dy herë, ose bashkëaplikant në të dyja Lotet (LOT1 dhe LOT 2) njëherazi.

26. Si do funksionojë rimbursimi i transportit në rast të shpalljes fitues të projekt propozimit?

Për të rimbursuar transportin për udhëtimet e parashikuara, organizatat mund të përdorin tarifën standarde që përdorin gjithmonë në varësi të kilometrave. Nëse nuk kanë një tarifë të përcaktuar, mund

të përcaktojnë një për projektin. Kur janë të disponueshme biletat, rimbursimi bëhet në bazë të biletave. Nuk ka një standard të përcaktuar mbi transportin nga projekti për t'u zbatuar nga fituesit e granteve.

27. A duhet të ndjekim një procedurë tenderimi për blerjet e projektit? Nëse po, cilat janë rregullat përkatëse?

Për blerjet mbi 2500 Euro duhet të ndiqet procedura e tenderimit me tre (3) oferta. Për blerjet nën 2500 Euro mund të bëhen blerje pa tenderim.

28. A është e nevojshme të publikohen prokurimet e projektit në APP (Agjencinë e Prokurimit Publik)?

Jo, nuk është e nevojshme. Mjafton që të merren 3 oferta dhe të bëhet përzgjedhja e fituesit sipas kushteve të përcaktuara në Termat e Referencës (ToR).

29. A lejohen rialokimet e fondeve brenda buxhetit të projektit? Nëse po, cilat janë kushtet dhe procedurat e nevojshme?

Rialokimet e fondeve brenda buxhetit të projektit lejohen me kërkesë zyrtare, justifikim të qartë, dhe specifikim të zërave nga të cilët hiqen dhe ku transferohen fondet. Miratimi paraprak nga autoriteti që jep fondin është i nevojshëm. Një rialokim i kryer pa miratim mund të mos njihet dhe mund të ketë pasoja financiare. Është e rëndësishme që organizata zbatuese të konsultohet me autoritetin që jep fondin për të marrë udhëzime specifike mbi procedurat e rialokimit.

30. Nëse në projekt planifikojmë të përfshijmë blerjen e biopesticideve për të mbështetur fermer të përzgjedur dhe siguruar cilësinë e një produktit që ata prodhojnë, a konsiderohet ky shpenzim si pjesë e zërit të "Investimeve" për Grantet Rajonale?

Sipas natyrës së tyre, blerja e biopesticideve zakonisht nuk konsiderohet si pjesë e zërit "Investim" në Grantet Rajonale. Kjo për arsyen se biopesticidet janë materiale të konsumueshme që përdoren gjatë ciklit të prodhimit bujqësor. Shpenzimet për inpute bujqësore, si pesticidet (edhe ato bio), zakonisht klasifikohen si shpenzime operationale ose të prodhimit, të cilat ndihmojnë në realizimin e prodhimit për një sezon të caktuar dhe nuk janë aktive afatgjata.